

UDHËZIM
Nr. 1738, datë 12.3.2015

**MBI KRITERET E STUDIM-PROJEKTIMIT PËR REHABILITIMIN E
VENDEPOZITIMEVE TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE, SI DHE NDËRTIMIN E
LANDFILLEVE APO IMPIANTEVE TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE TË NGURTA
URBANE**

Në mbështetje të nenit 102, paragrafi 4, të Kushtetutës, paragrafit III, pika 5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 25.2.2015 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 944, datë 9.10.2013, të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit”, ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe akteve nënligjore në funksion të tij, direktivës së EU 99/31/EC, “Për landfillin e mbetjeve”, ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, si dhe në zbatim të pikës 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 333, datë 26.1.2011, “Për administrimin e venddepozitimeve rajonale të mbetjeve urbane, aneksit I të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 11.7.2012, “Për landfilled e mbetjeve”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 19.1.2011, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”, është përgatitur udhëzimi “Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane”,

UDHËZOJMË:

Qarkun dhe/ose bashkinë, që për:

1. Hartimin e studim-projektimit për mbylljen /rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese të mbetjeve të ngurta urbane (shtojca 1);

2. Hartimin e studim-projektimit për ndërtimin e landfilleve apo impianteve të reja të mbetjeve të ngurta urbane (shtojca 2),

të zbatojnë me rigorozitet termat e referencës, si dhe shtojcat bashkëngjitur këtij udhëzimi.

TERMAT E REFERENCËS

**STUDIMI PËR MBYLLJEN/REHABILITIMIN E VENDEPOZITIMEVE EKZISTUESE TË
MBETJEVE TË NGURTA URBANE**

Të dhëna të përgjithshme:

1. Përshkrimi i përgjithshëm i projektit. Objektivat dhe arsyet e zhvillimit të këtij projekti.

a) Gjendja ekzistuese: Vendndodhja e projektit, të dhëna të përgjithshme mbi pozicionin gjeografik, relievin, popullsinë, klimën etj.

2. Objektivat

a) Objektivi i përgjithshëm: Adresimi i problemeve aktuale, lidhur me venddepozitimet ekzistuese të mbetjeve, të cilat përbëjnë rrezikshmëri të lartë për qendrat urbane dhe zonat turistike, reduktimi i rrezikut mjedisor dhe atij shëndetësor, që vjen si rezultat i administrimit të papërshtatshëm të mbetjeve të ngurta urbane, parandalimi i krijimit të “hotspote” me pasojë të rënda për gjeneratat e ardhshme.

b) Objektiva specifike: Përmirësimi i situatës mjedisore, reduktimi i mbetjeve, rehabilitimi i tokës dhe administrimi i hapësirave publike.

3. Të dhëna mbi situatën aktuale të administrimit të mbetjeve

a) Situata ekzistuese dhe menaxhimi aktual i mbetjeve, ku të përfshihen të dhëna mbi vendndodhjen e venddepozitimit, skemën e pastrimit, popullsinë, tarifat, vjelja e tarifës nga NJQV-ja, opinionin e banorëve të zonës, kërkesat e NJQV-së, si dhe të dhëna të tjera historike mbi mbetjet.

b) Gjendja aktuale për venddepozitimet ekzistuese, pozicionimi në lidhje me qendrat e banuara (genplani), distancat, përmasat, si dhe sasia e mbetjeve që janë të depozituara në to, si dhe nëse është evidentuar ndonjë problem mjedisor apo shëndetësor gjatë kohës, që ka qenë aktiv.

c) Vlerësimi paraprak i riskut social.

Hartimi i studimit

Për hartimin e projektit për mbylljen e venddepozitimit ekzistues është shumë e rëndësishme të kryhen studimet e mëposhtme:

1. Studimi gjeolog-inxhinierik, hidrogeologjik dhe sizmik, për vlerësimin e gjendjes së fushës ekzistuese, ku janë të depozituara mbetjet e ngurta urbane.

Ky studim duhet të përmbajë:

- a) studimi gjeologjik;
- b) studimi hidrogeologjik, veçanërisht përcaktimi i nivelit të ujërave nëntokësore;
- c) studimi hidrologjik;
- d) studimi gjeoteknik i fushës (erozioni, rrëshqitjet, përmytjet etj.);
- e) kushtet sizmike.

2. Relacioni teknik i studimit për mbylljen e venddepozitimit aktual të mbetjeve të ngurta urbane

Në këtë raport duhet të përfshihen:

- a) sistemi i grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- b) sistemi i grumbullimit dhe largimit të ujërave atmosferike;
- c) sistemi i grumbullimit, përdorimit apo trajtimit të biogazit;
- d) rrethimi perimetral;
- e) mbyllja e venddepozitimit/mbulimi për-fundimtar;
- f) monitorimi dhe mirëmbajtja pas mbylljes (minimalisht 15 vjet).

Projekti përfundimtar dhe preventivi

Studimi duhet të përfshijë dy opsione për rehabilitim, duke dhënë rekomandime për opsionin më optimal nga pikëpamja teknike dhe financiare. Ky opsion do të zhvillohet në të gjitha detajet e kërkuara për zbatim, si më poshtë.

Do të përcaktojë vlerën e përlogaritur për financimin për mbylljen e venddepozitimit dhe do të përmbajë:

1. Përmasat e venddepozitimit që do të mbyllet (planimetria, si dhe dimensionet referuar pjesës fundore të tij);

2. Volumin e mbetjeve, duke përfshirë kuotat minimale dhe maksimale të mbushjes (përfshirë shtresat mbushëse të argjilës);

3. Sistemin e rrjetit kullues dhe të drenazheve të ujërave që grumbullohen në venddepozitimin e mbyllur, nga reshjet e shiut, si dhe dimensionimin e tyre për ngjarje meteorike me periodë kthimi 10 vjet;

4. Administrimin e sistemit të kapjes së bogazit, ku të jepen të dhëna për numrin dhe karakteristikat e puseve të kapjes dhe, gjithashtu, mënyra (forma) e grumbullimit dhe përdorimit të tij;

5. Infrastrukturën shtesë që nevojitet për venddepozitimin që do të mbyllet (rrugët, kanalizimet, rrethimin e jashtëm, pemëzimin, ndërtesën e shërbimeve, mjetet dhe makineritë që do të shërbejnë në mirëmbajtje etj.);

6. Plani i administrimit operativ, postoperativ i mbikëqyrjes dhe i kontrollit të venddepozitimit, duke përfshirë format dhe mënyrat e administrimit (skemën funksionale);

7. Grafikun e punimeve dhe të shërbimeve;

8. Projekti i plotë për mbylljen e venddepozitimit, shoqëruar me preventivët përkatës;

TERMAT E REFERENCËS PËR STUDIM-PROJEKTIMIN

E NJË LANDFILLI APO IMPLANTI TRAJTIMI PËR MBETJET E NGURTA URBANE

Të dhëna të përgjithshme

1. Përshkrimi i përgjithshëm i projektit:

a) Objektivat dhe arsyet e zhvillimit të këtij projekti.

b) Vendndodhja e zonës së projektit, të dhëna të përgjithshme mbi pozicionin gjeografik, relievin, popullsinë, klimën etj.

2. Objektivat

a) Objektivi i përgjithshëm: Adresimi i problemeve aktuale, lidhur me administrimin e papërshtatshëm të mbetjeve të ngurta urbane, reduktimi i rrezikshmërisë së ndotjes mjedisore për qendrat urbane dhe zonat turistike, reduktimi i rrezikut mjedisor dhe atij shëndetësor, parandalimi i krijimit të “hotspoteve” me pasoja të rënda për gjeneratat e ardhshme.

b) Objektiva specifike

1) Krijimi i një sistemi menaxhimi mbetjesh, që do të ndihmojë në reduktimin e mbetjeve që

depozitohen në landfill dhe në arritjen e objektivave kombëtarë të caktuar nga strategjia dhe plani kombëtar i menaxhimit të mbetjeve;

2) Organizimi i procesit të grumbullimit dhe transportit për në venddepozitim;

3) Krijimi i një ambienti që nxit arritjen e objektivave për riciklim, kompostim ose rikuperim.

3. Të dhëna mbi situatën aktuale të administrimit të mbetjeve

a) Situata ekzistuese dhe menaxhimi aktual i mbetjeve, ku të përfshihen të dhëna mbi vendndodhjen, skemat e shërbimit të pastrimit, popullsinë, sasia e mbetjeve/banor/vit, tarifat, vjelja e tarifës nga njësitë e qeverisjes vendore, opinioni i banorëve të zonës, kërkesat e NJQV-ve, si dhe të dhëna të tjera historike mbi mbetjet.

b) Gjendja aktuale për venddepozitimet ekzistuese, pozicionimi, në lidhje me qendrat e banuara (genplan), distancat, përmasat, si dhe sasia e mbetjeve që janë depozituar në to.

c) Sasia e mbetjeve, që mendohet të depozitohen në venddepozitim të ri për mbetjet bashkiake;

d) Skemat e grumbullimit dhe transportimi i tyre;

e) Mundësitë për riciklim, kompostim dhe rikuperim.

Për përcaktimin e një venddepozitimi kërkohet të merren në konsideratë të dhëna të përgjithshme, për të paktën 10 variante të mundshme mbi vendndodhjen, nga ku të evidentohen avantazhet dhe dizavantazhet për secilin variant dhe në bazë të një vlerësimi/pikëzimi të përcaktohen 3 variantet më të përshtatshmet, të cilat do të përfshihen në studimin për ndërtim. Në përfundim do të përzgjidhet varianti që plotëson kriteret maksimale dhe më të favorshme për këtë qëllim.

Hartimi i studimit për ndërtim

Studimi për ndërtimin e një venddepozitimi të kontrolluar duhet të përmbajë dokumentacionet teknike të mëposhtme:

a) Studimin gjeologjik (9 kriteret bazë)

- kushtet geomorfologjike;

- homogeniteti vertikal dhe horizontal i trupit shkëmbor;

- përbërja mineralogjike dhe petrografike: përmbajtja e piritit;

- karakteristikat granulometrike dhe mekanike të dherave;

- parametrat makrostrukturorë;

- qëndrueshmëria e sipërfaqes;

- prezenca e depozitimeve minerale në nëntokën e studiuar dhe zonën përreth saj;

- kushtet hidrogeologjike.

b) Vlerësim i sheshit (luginës) që do të përdoret për këtë qëllim, ku të merren në konsideratë përmasat, sasia e mbetjeve të parashikuara, si dhe jetëgjatësia për të cilën do të shërbejë impianti i ri, si dhe distancat nga zonat e banuara dhe zona të tjera me interes të veçantë.

c) Studimi hidrogeologjik dhe hidrologjik;

- Nivelin maksimal dhe minimal të ujërave nëntokësore në pranverë dhe në vjeshtë (kuota duhet të jepet referuar në të njëjtën formë edhe në vizatimet e projektit);

- Vlerësim i drejtimit të fluksit të ujërave nëntokësore.

d) Studimi gjeoteknik i fushës (erozioni, rrëshqitjet, përmytjet etj.);

- Stratigrafinë e tokës në zonën dhe prerjet përkatëse, ku do të ndërtohet impianti i ri dhe në zonat përreth;

- Karakteristikat fizik-mekanike të materialeve që do të përdoren për realizimin e impiantit;

- Verifikimet për stabilitetin e bazës së venddepozitimit të ri dhe të argjinaturave perimetrale kundrejt volumit të depozituar të mbetjeve;

- Vlerësimet e koeficientit të sigurisë dhe të cedimeve të mundshme që volumi i depozituar i mbetjeve do të ketë me kalimin e kohës;

- Rilevim topografik i përgjithshëm i zonës (shkalla 1:25000), ku përcaktohet saktë zona ku do të ndërtohet venddepozitimi i ri;

- Planimetri e përgjithshme (shkalla 1:10000), ku specifikohen qartë dimensionet e sipërfaqes ku do të ndërtohet venddepozitimi i ri;

e) studimi sizmik (kushtet tektonike, sizmiciteti, gjeodinamika);

f) studimi klimatik-meteorologjik (ku të merret parasysh impakti i erërave të forta, si dhe drejtimi i erës);

g) studimi për lidhjet rrugore dhe trafikun;

h) vëzhgime, prova dhe testime të terrenit;

i) opinionimi publik.

Raporti teknik i studimit të venddepozitimit të mbetjeve të ngurta urbane, duhet të përfshijë:

- Distanca nga:

a) zona neutrale apo kufiri i pronës;

b) shtëpia më e afërt, si dhe qendrat e banuara;

c) autostradat dhe rrugët nacionale (ose nga rruga kryesore) që kalon pranë zonës, ku do të ndërtohet impianti i ri;

d) pusët dhe brigjet e jashtme të liqeneve dhe rrjedhave të ujit që përdoren si burim për ujë të pijshëm;

e) aeroporti, si dhe hekurudha më e afërt.

- Tipologjia e mbetjeve që do të depozitohen, karakteristikat fizik-kimike dhe sasia e mundshme e tyre;

- Kohëzgjatja e punimeve (grafik punimesh);

- Plani i rigjenerimit dhe i rehabilitimit mjedisor të zonës:

a) të dhëna për destinacionin e ardhshëm (vizatime shtjelluese dhe relacion ilustrativ sqarues);

b) të dhëna mbi kohëzgjatjen e punimeve dhe fazat për rigjenerimin dhe rehabilitimin mjedisor.

- mënyrën e depozitimit të mbetjeve;

- kuotën minimale, ku do të depozitohen mbetjet, si dhe atë maksimale, duke marrë parasysh dhe materialet mbushëse që mbyllin landfillin;

- volumi bruto dhe neto i mbetjeve, duke marrë parasysh shtresat mbushëse të argjilës;

- shkallën e ngjeshjes që synohet të arrihet, si dhe mjetet që do të shërbejnë për këtë qëllim;

- sistemin e drenazhit për ujërat meteorike (reshjet) jashtë impiantit të ri;

- sistemin e rrjetit kullues dhe të drenazheve të ujërave që grumbullohen në impiant, nga reshjet e shiut dhe dimensionimin e tyre për ngjarje meteorike me periudë kthimi 10 vjet;

- diametrat dhe materialet e tubacioneve që do të përdoren për këtë sistem kullimi dhe drenazhimi;

- masat që do të ndërmerren për heqjen e ujërave meteorike (reshjet) që grumbullohen në brendësi të venddepozitimit të ri, në zonat që nuk janë okupuar ende me mbetje;

- sistemi i kapjes së bogazit, ku të jepen të dhëna për numrin dhe karakteristikat e puseve të kapjes dhe, gjithashtu, mënyra (forma) e grumbullimit të tij.

- format dhe mënyrat e administrimit të impiantit (skemën funksionale);

- infrastrukturën shtesë të impiantit (peshore, rrethimin e jashtëm, pemëzimin, ndërtesën e shërbimeve, mjetet dhe makineritë që do të shërbejnë në impiant (rul me dhëmbë etj.), lavazhin, sistemin antizjarr, ndriçimin e jashtëm);

- karakteristikat gjeometrike dhe numrin e puseve monitoruese të ujërave nëntokësore në zonën përreth;

- mënyrat dhe pajisjet që do të përdoren për të zvogëluar impaktet e shkaktuara nga ky aktivitet (pluhuri, zhurmat, aromat);

- planimetria, ku tregohen sistemi i grumbullimit dhe i kullimit të ujërave, sistemi i kapjes së biogazit dhe sistemit të kullimit të reshjeve;

- planimetri ku tregohen pajisjet, objektet e shërbimeve dhe ato të rrjetit të monitorimit;

- vizatime të objekteve të ndërtuara jashtë venddepozitimit, që do t'i shërbejnë atij (ndërtesa e zyrave të shërbimeve, lavazhit për automjetet që do të depozitohen mbetje, rrethimin e jashtëm, vendin ku do të vendoset peshorja etj.);

- planimetria e plotë e projektit (shkalla 1:1000 ose 1:500), ku janë të paraqitura dimensionet dhe, gjithashtu, kuotat e bazës kundrejt zonës përreth dhe ndonjë objekti të mirëpërcaktuar;

- prerje tërthore dhe gjatësore (në shkallë të përshtatshme) e venddepozitimit të ri, në gjendjen fillestare (pa filluar depozitimi i mbetjeve);

- prerje tërthore dhe gjatësore (në shkallë të përshtatshme) e venddepozitimit të ri, në fazën e mbylljes (pasi është mbushur plotësisht me mbetje dhe mbuluar);

- të përfshihet, gjithashtu, plani i operimit dhe i mirëmbajtjes.

2. Për të zvogëluar shpenzimet e transportit në studim, mund të parashikohen edhe stacionet e transferimit (për ato bashki mbi 15 km larg) konceptuar si pikëlidhje me kosto efektive.

3. Vlerësimi ekonomik (studim i fizibilitetit ekonomik, i cili nënkupton raportin e buxhetit për menaxhimin e mbetjeve, duke përcaktuar tarifën e hyrjes në landfill, me të gjitha elementet e saj):

a) për variantin e përzgjedhur;

b) parashikimi për të ardhmen.

Në përcaktimin përfundimtar të vendndodhjes së landfillit apo të impiantit, do të parashikohet procedura

e informimit të komunitetit, si dhe pjesëmarrja në vendimarrje, në nivel vendor, bazuar në ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, si dhe Konventën e Arhusit.

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN

Eglantina Gjermeni

MINISTRI I MJEDISIT

Lefter Koka

SHTOJCA 1
DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR STUDIMIN
E MBYLLJES/REHABILITIMIT TË NJË VENDDEPOZITIMI

Nr.	Emërtimi i dokumentacionit
1	Detyra e projektimit e hartuar nga specialisti i fushës
2	Studimi gjeolog-inxhinierik, hidrogeologjik dhe kushtet sizmike të zonës (ku të përfshihen materialet teknike përkatëse)
3	Relacioni teknik i hartuar dhe firmosur nga projektuesi
4	Grafiku i punimeve dhe i shërbimeve
5	Projekti përfundimtar i shoqëruar me preventivat përkatës
6	Dokumentet e pronësisë
7	Vlerësimi i shpronësimeve
8	Oponenca teknike nga Instituti i Ndërtimit
9	Studim i vlerësimit të ndikimit në mjedis, bazuar në legjislacionin në fuqi
10	Studim për shfrytëzimin e gazrave
11	Leja mjedisore përkatëse
12	Leja e ndërtimit

SHTOJCA 2
DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR STUDIM-PROJEKTIMIN
E NJË LANDFILLI APO IMPIANTI TRAJTIMI PËR MBETJET E NGURTA URBANE

Nr	Emërtimi i dokumentacionit
1	Detyra e projektimit e hartuar nga specialisti i fushës
2	Vërtetim nga kadastra e bashkisë/qarkut mbi kategorizimin e truallit që kërkohet për shfrytëzim
3	Mendimi i ministrive të linjës, veçanërisht lidhur me përdorimin e tokës dhe zonat e mbrojtura (të rëndësishme turistike, kulturore, arkeologjike, bujqësore dhe natyrore)
4	Plani i detajuar vendor, si dhe projekti i miratuar nga organet përkatëse në përputhje me ligjin e planifikimit të territorit dhe të instrumenteve të tjera kombëtare e

	vendore të planifikimit
5	Studimi gjeologjik, hidrogeologjik dhe hidrologjik, sizmik, klimatik-meteorologjik (ku të përfshihen materialet teknike përkatëse)
6	Studimi i zonës, në lidhje me infrastrukturën rrugore dhe trafikun e parashikuar
7	Vëzhgime prova dhe testime të terrenit
8	Opinionit publik
9	Dokumentet e pronësisë, si dhe vlerësimi i shpronësimeve (duhet të zgjidhen përpara fillimit të punimeve civile, për të mos krijuar vonesa në zbatim)
10	Relacioni teknik i hartuar dhe i firmosur nga projektuesi, si dhe procedurat e përzgjedhjes së vendit për ndërtimin e landfillit/impianitit të mbetjeve të ngurta urbane
11	Vlerësimi ekonomik
12	Oponenca teknike nga Instituti i Ndërtimit
13	Miratimi i studimit në organet përkatëse
14	Studim i vlerësimit të ndikimit në mjedis
15	Leja mjedisore përkatëse
16	Leja e ndërtimit